



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 286/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Nenad Lazic dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit Lëvizja Vetëvendosje (LVV) në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore në ditën e votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 11.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit Lëvizja Vetëvendosje LVV në Prishtinë.

Arsyetim

Me datën 09.06.2014, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në Prishtinë, ka parashtruar ankesë në PZAP, ku thekson se në lagjen “Kodra e Trimave” përgjatë ditës së votimit, një furgon i modelit Mercedes MB100 Diesel me nr. të targave 01-176-F0, i mbuluar me logo dhe shenja partiake me karakter propagandistik të LDK-së i mbushur me mbështetës partiak, brohoritnin emrin e kryetarit të subjektit politik LDK nëpër rrugët e qytetit dhe në afërsi të QV Sh.F. “Zenel Hajdini”.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i vlerëson se pretendimet e parashtruesit të ankesës nuk qëndrojnë, sepse nga provat e ofruara në ankesë nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur një gjë e tillë në ditën e votimit, veprim ky që do të thyente heshtjen zgjedhore. Me këtë rast PZAP-i, konstatoi se një pretendim i tillë është i pa argumentuar me prova dhe dëshmi bindëse, andaj në kuptim të nenin 3.6 pika c) të Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it si dhe nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 286/2014 më datën 11.06.2014



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.